



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
INSPEKTORIATI I MBROJTJES SE TERRITORIT

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____._____.2025

Lënda: Kthim përgjigje

Ne vijim të kërkesës Tuaj nr. 14783/prot dt. 21.07.2025 bazuar në Kodin e Procedurës Administrative, referuar ligjit 9780 datë 16.07.2016 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” i ndryshuar, ju sqarojmë si më poshtë vijon:

IMT-ja Bashkia Shkodër pasi ka patur nën kontroll dhe në vëmendje zonën Thethit si zonë e rëndësisë së veçantë “Park Natyrorë” dhe ka evidentuar duke konstatuar:

Për vitin 2022 janë konstatuar **13 raste ndërtimesh** të kundërligjshme për te cilat janë ezauruar të gjitha procedurat ligjore duke marrë masa administrative dhe duke i referuar pranë Prokurorisë se Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër. Është vijuar duke u ndërmarrë aksione për prishjen e objektit të tyre të cilat për mungese të logjistikës specifike dhe për shkak te kësaj zone nuk janë realizuar.

Për vitin 2023 janë konstatuar **26 raste ndërtimesh** të kundërligjshme për te cilat janë ezauruar të gjitha procedurat ligjore duke marrë masa administrative dhe duke i referuar pranë Prokurorisë se Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër. Është vijuar duke u ndërmarrë aksione për prishjen e objektit të tyre të cilat për mungese të logjistikës specifike dhe për shkak te kësaj zone nuk janë realizuar.

Për vitin 2024 janë konstatuar **16 raste ndërtimesh** të kundërligjshme për te cilat janë ezauruar të gjitha procedurat ligjore duke marrë masa administrative dhe duke i referuar pranë Prokurorisë se Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër. Është vijuar duke u ndërmarrë aksione për prishjen e objektit të tyre të cilat për mungese të logjistikës specifike dhe për shkak te kësaj zone nuk janë realizuar.

Për vitin 2025 deri në dt. 12.07.2025 korrik janë konstatuar **50 raste ndërtimesh** të kundërligjshme për te cilat janë ezauruar të gjitha procedurat ligjore duke marrë masa administrative dhe duke i referuar pranë Prokurorisë se Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër. Është vijuar duke u ndërmarrë aksione për prishjen e objektit të tyre të cilat për mungese të logjistikës specifike dhe për shkak te kësaj zone nuk janë realizuar. Pas kërkesës për mbështetje IKMT-se Tirane ne dt.04.07.2025 u ndërhyrje për realizimin e tyre ne dt. 07.07.2025 e ne ditët ne vijim.

Tipologjia e ndërtimit sikurse është e përshkruar ne tabelat bashkëlidhur janë me konstrukt druri por nuk mungojnë dhe atë me konstrukt beton arme.

Ju bëjmë me dije se fshati Theth është një zone e cila ka problematika për tu pajisur me leje ndërtimit gjë e cila nuk është kompetence e IMT-se dhe pavarësisht bashkëpunimit me Drejtorin e Planifikimit nuk jep ndikim ne parandalimin e ndërtimeve te kundërligjshme.

Detyrimi ligjor i IMT-se duke pare trendin ne rritje te ndërtimeve është të intensifikojë inspektimet dhe të vijoj me masat shtrënguese ligjore për parandalimin e çdo ndërhyrje ne territor.

Bashkëlidhur ju dërgojmë tabelat e çdo vendimi për prishje objekti të kundërligjshëm i konstatuar nga IMT-ja për vitet 2022 -12.07.2025

Duke ju falenderuar për punën !

K R Y E T A R

BENET BECI

)